



# INFORMACIONE

## PASQYRA E AKTIVITETEVE TE MUAJIT PRILL

Mbledhja e Bordit Drejtues të AOSH

Agjensitë e UN, KOKSH, MKRS dhe MASH Lançimi i projektit të përbashkët « *Rinia dhe Sporti për zhvillim* »

Mbledhje e Komitetit Ekzekutiv te KOKSH  
në Hotel Tirana International

Mbledhje KAS

Seminari « Mbi Metodologjinë e Stërvitjes Sportive »

Prill Sesioni i8-të Ndërkombëtar i IOA

Prill Sekretariati i COE në Tiranë

« Almeria 2005 » - Mbledhje e KE të KOKSH

Përfundojnë akreditimet e kandidatëve sportistë për  
« Almeria 2005 »

COE Seminar - Prezantimi i skuadrës së Vullnetarëve



Komiteti Ekzekutiv - mbledhje



Bordi i AOSH - mbledhje



ICMG "Seminar 2005"

#### 4 Prill - Mbledhja e Bordit Drejtues të AOSH

Bordi Drejtues i Akademisë Olimpikë Shqiptare zhvilloi në ambjentet e KOKSH mbledhje të zgjeruar me anëtarët e tij. Ndër pikat kryesore që u Bordi diskutoi, ishin :

Sesioni vjetor i të rinjëve, Sesioni vjetor i AOSH, Edukimi Olimpik – Paketa Olimpikë, Quizi Olimpik, Eseja Olimpikë, Mbështetja e aktiviteteve Olimpikë në shkolla apo universitete, etj, gjithashtu u diskutua mbi edhe mbi mënyrën e organizimit të këtyre aktiviteteve. Me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KOKSH, Presidentit dhe Drejtorit të AOSH, në këtë mbledhje u diskutua mbi planin e punës për vitin 2005-2006. Bordi vendosi që, si të gjitha Akademitë Olimpikë në vendet e tjera, AOSH të bashkëpunojë sa më shumë me Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sportit.



#### 5 Prill - Agjensitë e UN, KOKSH, MKRS dhe MASH Lançimi i projektit të përbashkët « Rinia dhe Sporti për zhvillim ».

Pas një pune 1 vjeçare dhe koordinuese, me seminare dhe takime të ndryshme midis partnerëve pjesëmarrës në hartimin e Projektit « **Rinia & Sporti për Zhvillim** », në datën 5 Prill 2005, në Hotel Rogner, Zyra Koordinuese e Agjensive të UN në Shqipëri, KOKSH, MKRS dhe MASH dolën në një konferencë për shtyp ku promovuan lançimin e projektit të përbashkët « **Rinia & Sporti për Zhvillim** » ne kuader te vitit 2005 – te deklaruar nga CIO dhe UN si Viti Nderkombetar i Sportit dhe Edukimit Fizik. Titullarët e të katër institucioneve, zj. Anna

*Stjarnerklint* Ambasadore e UN në Shqipëri, zj. *Hysen Domi* President i KOKSH, zj. *Edmond Dragoti* zv/Min. i MKRS dhe zj. *Edlira Haxhijmeri*, zv/Min. i MASH, e vlerësuan këtë iniciativë të përbashkët dhe u shprehën se ky është një projekt unik ku sporti shikohet si një mjet shumë i rëndësishëm për rininë dhe zhvillimin.



Presidenti i KOKSH theksoi se bashkërendimi në të tilla projekte është i rëndësishëm dhe pohoi se lançimi i këtij projekti është shumë domethënës për kontributin e KOKSH në Shqipëri, sepse tashmë KOKSH i ka ngritur strukturat e tij në 6 qarqe të vendit.

#### 13 Prill - Mbledhje e Komitetit Ekzekutiv te KOKSH në Hotel Tirana International

Kjo mbledhje shumë e rëndësishme për KOKSH, e cila është e dyta për nga radha, kishte në fokus informimin për masat e marra në lidhje me organizimin e Mbledhjes së 26-të të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe Shefave të Misionit të Komiteteve Olimpikë Europiane e cila zhvillohet në Tiranë më datat 6 -7 Maj 2005. Përveç anëtarëve të KE të KOKSH, të ftuarit që morrën pjesë në këtë mbledhje ishin : *Edmond Dragoti*, zv/Min. i MKRS; *Përparim Kabo*, Këshilltar për Kulturën dhe Sportin pranë Kryeministrit; *Roland Bimo*, Sekretar i Përgjithshëm i Min. së Punëve të Jashtme; *Artan Didi*, Drejtor i Rendit dhe Sigurisë Publike pranë MRP; dhe të ftuar të tjerë si Drejtori i Përgjithshëm i AMC *Stefanos Octapodas* dhe *Arben Jorgoni* ish President i KOKSH.



Të ftuarit e në mbledhje dhe njëkohësisht përfaqësues të shtetit, njëzëri vlerësuan rëndësinë e organizimit të Mbledhjes së COE në Shqipëri dhe secili prej tyre u shpreh për përgjegjësitë që çdo institucion të marri në prezantimin sa më të mirë të Shqipërisë. Përveç çështjes së organizimit të mbledhjes së COE, KE i KOKSH diskutoi mbi përgatitjet për Lojrat Meshdhetare « Almeria 2005 », Seminarin « Metodologjia e Stërvitjes Sportive » më datat 15-17 Prill, për Përgatitjet e FOJE Lignano Sabbiadoro (Italy), më dt. 2-9 Korrik 2005 dhe informacion mbi mbledhjet e komisioneve të KOKSH të zhvilluara këtë periudhë.

#### 14 Prill - Mbledhje KAS

Më dt. 14 Prill 2005 në ambjentet e KOKSH, Këshilli i Gjykatës Sportive morri në shqyrtim ankesën e z. Faruk Kalleshi, Trainer i Peshëngritjes : « Anullimi i vendimit të Kryesisë së Federatës së Peshëngritjes për përjashtimin e tij përgjithmonë nga peshëngritja ». Këshilli i Gjykatës Sportive vendosi :

- 1- Pranimin e kërkesës së z. Faruk Kalleshi për anulimin e vendimit të Federatës Shqiptare të Peshëngritjes.
- 2- Anullimin e vendimit të Komitetit Drejtues të Federatës Shqiptare të Peshëngritjes, si të pabazuar në aktet e brendshme ligjore të Federatës.

#### 15-17 Prill - Seminari « Mbi Metodologjinë e Stërvitjes Sportive »/ KOKSH, ICMG, AEFS

KOKSH në bashkëpunim me AEFS « Vojo Kushi », Scuola di Sport di Sicilia nën patronazhin e Komisionit për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Lojrave Meshdhetare ICMG, kanë zhvilluar Seminarin 3 ditor « Mbi Metodologjinë e Stërvitjes Sportive ». Me më shumë 60 pjesmarrë, nga të cilët Trainerë të Klubeve sportive nga e gjithë Shqipëria, Pedagogë të AEFS, Mësues të Edukimit Fizik dhe Kërkues Shkencor, ky seminar u fokusua mbi disa tema kyçe që shqetësojnë sportin e të rinjëve si :

- Ngarkesat në stërvitjen e të rinjëve
- Identifikimi dhe mbështetja e talentit
- Kryerja dhe analizimi i testeve të ndryshme për stërvitjen e të rinjëve
- Aspekte psikologjike në sport, etj.



Lektorë në këtë seminar ishin profesorët e ardhur nga Scuola di Sport di Sicilia z. Giandomenico Pellegrino (metodist), Fulvio Giardina (psikolog sportiv), dhe ata Shqiptar Prof. Dr. Arben Jorgoni AEFS « Vojo Kushi » dhe Prof. Dr. Albert Karriqi, Qendra Kërkimore Shkencore e Sportit. Gjithashtu në kuadër të bashkëpunimit midis KOKSH, AEFS dhe Scuola di Sport di Sicilia, të tre institucionet arritën të konkludojnë nënshkrimin e një Marrëveshje Bashkëpunimi.

18 - 25 Prill

**Sesioni i8-të Ndërkombëtar i IOA**

Presidenti dhe Drejtori i Akademisë Olimpike Shqiptare morrën pjesë në Sesionin e 8-të Ndërkombëtar të Drejtorëve të Akademive Olimpike Kombëtare, Olimpia - Greqi. Si në çdo Sesion të Akademisë Olimpike Ndërkombëtare, çështja më kryesore për diskutim është « Olimpizmi ». Ndërsa temat speciale në këtë Sesion të 8-të ishin mbi : Akademia Olimpike Ndërkombëtare – Struktura, Objektivat dhe Operimi i Akademive Olimpike Kombëtare.

**20-21 Prill Sekretariati i COE në Tiranë**

Në kuadër të Mbledhjes së 26-të të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe Shefave të Misionit e cila do të zhvillohet në Tiranë më 6-7 Maj 2005, kanë ardhur në Tiranë për një vizitë pune 2 ditore znj. Sabrina Rettondini dhe z. Gianluca de Angelis, pjesë e stafit administrativ të Sekretariatit të Komitetit Olimpik European. Qëllimi i ardhjes së tyre ishte për të parë më nga afër përgatitjet e bëra para mbledhjes, për të zhvilluar takime pune për mbarëvajtjen e këtij aktiviteti.

21 Prill

**« Almeria 2005 » - Mbledhje e KE të KOKSH**

Në datën 21 Prill në ambjentet e KOKSH, Komiteti Ekzekutiv i KOKSH zhvilloi mbledhjen e 3-të të radhës. Rendi i ditës së kësaj mbledhje ishte mbi përgatitjet për « Almeria 2005 ». Përveç anëtarëve të KE, i ftuar në këtë mbledhje ishte i ftuar edhe zv/Min. i MKRS z. Edmond Dragoti. Presidenti KOKSH z. Domi, në emër të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, gjeti rastin të falenderojë në këtë mbledhje MKRS dhe në veçanti titullarët e saj Ministrin z. Blendi Klosi dhe zv/Min. z. Edmond Dragoti të cilët kanë treguar interes të veçantë në miratimin e Projektit të propozuar nga KOKSH për Skuadrën Shqiptare e cila do të përfaqësohet në Lojrat Mesdhetare « Almeria 2005 ».

Për këtë projekt MKRS ka akorduar shumën prej 7 milion lekë të reja, shumë e cila do të mbulojë shpenzimet e Skuadrës Olimpike Shqiptare për në Lojrat Mesdhetare « Almeria 2005 », Spanjë.

**22 Prill - Përfundojnë akreditimet e kandidatëve sportistë për « Almeria 2005 »**

Pas disa mbledhjeve intensive të Komisionit Teknik të KOKSH ku në fokus ka qenë informimi i Federatave Sportive në lidhje mbi procedurat e akreditimit dhe të përcaktimit të numrit të sportistëve kandidatë, në datë 22 Prill 2005 ka qënë afati i fundit i regjistrimit të tyre. Regjistrimi është bërë për çdo disiplinë sportive dhe gjithashtu është përcaktuar gara ku sportistët do të marrin pjesë.

**29 Prill COE Seminar - Prezantimi i Skuadrës së Vullnetarëve**

Në Hotel Sheraton u zhvillua ceremonia e prezantimit të Stafit Administrativ - Organizator për « Seminari i 26-të të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe Shefave të Misionit të Komitetit Olimpik European », i cili do të zhvillohet në Tiranë në datat 6-7 Maj 2005. Sekretari i Përgjithshëm i dhe Shefi i Misionit të KOKSH në prani edhe të mediave, prezantuan stafin që do të punojë për organizimin e aktivitetit i cili përbehet nga 12 Vullnetarë(vjaza dhe djem), 4 Asistentë dhe 5 Pjestarë të stafit të KOKSH. Në takim u përshëndet dhe u vlerësua angazhimi i vullnetarëve të cilët pranuan të ishin pjesë në këtë aktivitet ndërkombëtar.



KOMITETI OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR

Rruga: "Muhamet Gjollësja", 21 Dhjetori - Tel. +355 235249/240602 - Fax. +355 240565  
E-mail:secretariat@nocalbania.org.al - www.nocalbania.org.al

C  
I  
T  
I  
U  
S  
  
A  
L  
T  
I  
U  
S  
  
F  
O  
R  
T  
I  
U  
S